

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 11220/09

Sadik Llukacaj
kundër Shqipërisë
dhe 3 kërkesa të tjera
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 2 tetor 2022, si Komision, i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Frédéric Krenc, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit,*

Pasi morën në konsideratë kërkesat e mësipërme paraqitur në data të ndryshme, sipas tabelës bashkëlidhur,

Duke marrë në konsideratë parashtrimet e paraqitura nga Qeveria e paditur dhe parashtrimet e paraqitura nga kërkuesit si përgjigje ndaj të parave,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkuesve dhe detajet përkatëse të kërkesave janë paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

Kërkuesit u përfaqësuan nga z. B. Muslija, një avokat i cili e ushtron profesionin në Shkodër.

Ankesat e kërkuesve sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me tejzgjatjen e procedurave civile vendase, iu komunikuan Qeverisë së Shqipërisë (“Qeveria”).

LIGJI

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

Duke pasur në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata e gjykon të përshtatshme t’i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

Gjykata nënvizon se në mbështetje të nenit 35 § 2 (b) të Konventës, nuk do të shqyrtojë asnjë kërkesë të paraqitur në mbështetje të nenit 34, e cila është në thelb e njëjtë me një çështje që tashmë është shqyrtuar prej saj, në rast se kërkesa e re nuk përmban asnjë informacion të ri.

Për sa i përket ankesave të kërkuesve në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave civile në Gjykatën e Lartë, të cilat përfunduan më 25 prill 2014, Gjykata tashmë i ka shqyrtuar këto ankesa në vendimin e saj *Lacej dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ([Komisioni]), nr. 22122/08, 29 shtator 2022). Në këtë vendim, në lidhje me të njëjtën ankesë, Gjykata konstatoi një shkelje ndaj kërkuesve Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë dhe Komuniteti Musliman i Shqipërisë, u akordoi kompensim të drejtë, dhe i gjykoi të papranueshme ankesat e kërkuesve Llukacaj dhe Ulqinaku pasi nuk përputheshin *ratione personae* me parashikimet e Konventës.

Në mbështetje të rrethanave, Gjykata konstaton se këto ankesa, në thelb, janë të njëjta sipas interpretimit të nenit 35 § 2 (b) të Konventës, ashtu si edhe kërkesa e shqyrtuar prej saj në vendimin *Lacej dhe të tjerët*, cituar më sipër. Për këtë arsye, këto ankesa duhet të rrëzohen si të papranueshme në përputhje me nenin 35 § 4.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos t’i bashkojë kërkesat;

I deklaron kërkesat të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 10 nëntor 2022.

Viktoriya Maradudina
Zëvendësregjistrare e përkohshme

Andreas Zünd
Kryetar

SHTOJCË

Lista e kërkesave të cilat paraqesin ankesa në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës
(tejzgjatja e procedurave civile)

Nr.	Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkesit Viti i lindjes, ku është rasti
1	11220/09 13.5.2008	Sadik LLUKACAJ 1936
2	11225/09 13.5.2008	Adnan ULQINAKU 1940
3	11231/09 13.5.2008	Kisha Orthodokse Autoqefale e Shqipërisë
4	11232/09 13.5.2008	Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

